

VENDIM
Nr.767, datë 24.9.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.228, DATË 13.4.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DIETAT E NËPUNËSVE, QË DËRGOHEN ME SHËRBIM
JASHTË VENDBANIMIT TË TYRE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 10 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 6 të vendimit nr.228, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përgjashtimisht, efektivave të Gardës së Republikës u paguhet dietë edhe kur shërbimi kryhet në zona me largësi deri në 100 km nga qendra e punës, por që, për natyrë të veçantë shërbimi, nuk kthehen brenda ditës në vendbanimet e tyre.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Gardën e Republikës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 qershor 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha